



▶ Dokument politik

Programi i Ndhmës Ekonomike në Shqipëri : sfidat dhe tendencat e reformës

1. Hyrje

Një nga prioritetet e agjendës kombëtare në Shqipëri është reformimi i ndihmës sociale. Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka zbatuar një sërë reformash mbi skemën kryesore të ndihmës sociale monetare për familjet e varfra, të quajtur Ndhma Ekonomike ose programi i Ndhmës Ekonomike.

Në kuadër të punës së vazhdueshme për reformimin e skemës së ndihmës sociale në Shqipëri, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka kryer një analizë për të vlerësuar efektivitetin e programit të Ndhmës Ekonomike duke u bazuar tek standardet ndërkombëtare për sigurimin shoqëror, në veçanti tek Rekomandimi i ILO-s Nr. 202 për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale, si dhe objektivat zhvillimore të përcaktuara nga komuniteti ndërkombëtar, të deklaruara edhe në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Ky relacion del me një përmbledhje të sfidave me të cilat përballlet programi i Ndhmës Ekonomike në Shqipëri dhe paraqet çështjet kryesore që duhet të jenë objekt i diskutimit të mëtejshëm. Ai bazohet në raportin e ILO-s *Reforma e Programit të Ndhmës Ekonomike në Shqipëri: problemet dhe sfidat* (ILO, 2022) të përgatitur në kuadër të Programit të Përbashkët të OKB-së “Opsionet strategjike politike për financimin e OZhQ-ve”.

2. Pasqyrë e përgjithshme e programit të reformuar të Ndhmës Ekonomike

Sipas ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, grupet që mund të përfitojnë mbështetjen me anën e Ndhmës Ekonomike janë: familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme; jetimët që nuk janë të sistemuar në institucionet e përkujdesit social; prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur në të njëjtën kohë; viktimat e trafikimit; dhe viktimat e dhunës në familje.

Përfitimet përbëhen nga pagesa mujore në para dhe pagesa në natyrë, të cilat ofrohen për një periudhë maksimale prej pesë vitesh. Ky afat kohor nuk vlen për përfituesit që e kanë kaluar moshën e pensionit dhe për nënat e vetme. Masa e përfitimit në para përcaktohet duke u bazuar në madhësinë dhe përbërjen e familjes, siç tregohet në tabelën 1. Në vitin 2022, masa e përfitimit u rrit dy herë. Niveli i përfitimit tani varion nga 2,178 lekë për një familje me një person të vetëm në 12,672 lekë për dy të rritur me tre fëmijë.

Tabela 1. Pagesat mujore të Ndhmës Ekonomike sipas përbërjes së familjes, 2021 dhe 2022

Përbërja e familjes	1 i rritur	1 i rritur dhe 1 fëmijë	2 të rritur	2 të rritur dhe 2 fëmijë	2 të rritur dhe 3 fëmijë
Pagesa e NE 2019-2021	1,800 lek	2,700 lek	3,060 lek	4,860 lek	5,760 lek
Pagesa e NE 2022, janar - shtator	1,980 lek	2,970 lek	3,366 lek	5,346 lek	11,520 lek
Pagesa e NE 2022, tetor - e në vazhdim	2,178 lek	3,267 lek	3,703 lek	10,692 lek	12,672 lek

Burimi: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.9.2019, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 22.9.2022, dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë.

Shënim: Supozohet se personi kryefamiljar është grua dhe të rriturit janë nën moshën 65 vjeç.

Përveç pagesës në para, programi i Ndhmës Ekonomike ofron edhe pagesat e mëposhtme në natyrë:

- Shërbime shëndetësore falas në strukturat e kujdesit shëndetësor parësor dhe sekondar;
- Përrjashtim nga tarifa për fëmijët që frekuentojnë çerdhet/ kopshtet;
- Përrjashtim nga tarifa e shkollimit në universitet;
- Bursa për ndjekjen e arsimit universitar;
- Përrfitimi i teksteve shkollore pa pagesë për arsimin e detyrueshëm;
- Përrfitimi nga programet sociale të strehimit;
- Përrjashtimi nga tarifa e legalizimit/ regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Për të aplikuar për ndihmën ekonomike, familjet kandidate i nënshtrohen një interviste të kryer nga administratori shoqëror përrgjegjës për zonën e tyre, gjatë të cilës duhet të japin informacion në lidhje me kushtet e tyre të jetesës. Administratori shoqëror më pas kryen një vizitë në shtëpitë e familjeve aplikante për të verifikuar informacionin e vetëdeklaruar. Lista e aplikimeve të verifikuara i dërrgohet Drejtorisë Rajonale të Shërrbimit Social Shtetëror, e cila verifikon të dhënat e aplikantëve dhe vlerëson aplikimet nëpërrmjet përrdorimit të një formule të unifikuar pikëzimi (*proxy means test*). Aplikantët e refuzuar kanë të drejtë të apelojnë nëse nuk pajtohen me vendimin. Për të shmangur çdo gabim të mundshëm që çon në përrjashtimin e familjeve realisht në nevojë, gjashtë përrqind e buxhetit të Ndhmës Ekonomike iu kalon bashkive, të cilat mund ta përrdorin atë për të përrfshirë në skemën e NE-së, bazuar në vendimin e tyre, edhe familje të tjera të përrjashtuara nga kjo skemë për shkak të përrdorimit të formulës.

Familjet përrfituese të Ndhmës Ekonomike duhet të rikonfirmojnë statusin e tyre social-ekonomik çdo tre muaj dhe përrfituesit në moshë pune duhet të regjistrohen çdo muaj si punëkërrkues të papunë në zyrat vendore të punësimin për të vazhduar me përrfitimin e kësaj pagese. Sipas ligjit përrkatës, kohëzgjatja maksimale e parashikuar për përrfitimin e kësaj pagese është pesë vjet, përrveç rastit të përrfituesve mbi moshën e pensionit dhe nënave të vetme me fëmijë në ngarkim. Brenda kësaj periudhe pesëvjeçare, përrfituesit në moshë pune duhet të shfrytëzojnë mundësinë e trajnimit ose të mbështeten në forcat e veta përrmes sistemimit në tregun e punës.

3. Sfidat dhe problemet sa i takon politikave


Mbulimi dhe formula e unifikuar e pikëzimit për programin e reformuar të Ndhmës Ekonomike

Në kuadrin e zgjerimit të mbulimit të mbrojtjes sociale për të gjithë anëtarët e shoqërisë, programi i Ndhmës Ekonomike luan rol kyç, veçanërisht për mbrojtjen e grupeve të varfëra dhe të cenueshme.

Në vitin 2021, numri i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike ishte 62,030 (68,246 duke përfshirë edhe përfituesit nga fondi i bashkisë prej 6 për qind). Numri i individëve përfitues ishte 249,192, duke përfaqësuar kështu 9.0 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë shqiptare.¹ Në mesin e përfituesve në moshë pune, përbërja gjinore është pothuajse e barabartë me pak më shumë meshkuj se femra. Siç paraqitet në Figurën 1, numri i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike është ulur me 37.2 përqind nga viti 2012 në 2021. Numri i familjeve përfituese pësoi një rënie me 25.3 për qind në vitin 2014, me pilotimin e programit të reformuar në tre qarqe të mëdha dhe me 33.3 për qind në vitin 2018, me shtrirjen e reformës në mbarë vendin. Rënia e përqindjes ishte veçanërisht e konsiderueshme për familjet me një ose dy anëtarë.

Rënia e numrit të përfituesve të Ndhmës Ekonomike i atribuohet kryesisht metodës së re të shënjestrimit nëpërmjet formulës së unifikuar të pikëzimit, e cila çoi në uljen e përfshirjes së familjeve me nivel më të lartë të ardhurash. Në të njëjtën kohë, shifrat flasin edhe për një problem të mundshëm sa i takon përjashtimit nga skema të aplikantëve, në veçanti, të familjeve të varfëra të përbëra nga vetëm një person dhe përfituesve në moshë pune në grupmoshën 50-55 vjeç, të cilët e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune.

Figura 1. Numri i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike sipas madhësisë, 2010-2021



Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

1. Në muajin korrik të vitit 2021, familjet me nevoja të veçanta, si jetimët që nuk janë të sistemuar në institucionet e kujdesit social, prindërit e trenjakëve e më shumë, viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje, përbënin 2.8 përqind të numrit total të familjeve përfituese.

Sipas të dhënave të Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës të zhvilluar në vitin 2020, norma e mbulimit të programit të Ndhmës Ekonomike në decilin me të ardhurat më të ulëta ishte në masën 37.0 përqind dhe 25.8 përqind në kuintilin me të ardhura më të ulëta, duke lënë për të kuptuar se norma e përjashtimit ka qenë e konsiderueshme. Ajo që ka munguar deri më sot është kryerja e një vlerësimi sistematik të programit të Ndhmës Ekonomike sa i takon shënjestrimin dhe formulës së unifikuar të pikëzimit. Në fakt, as formula e pikëzimit dhe as pragjet për përcaktimin e kualifikueshmërisë së aplikantëve për të përfituar nga kjo skemë nuk janë të aksesueshme publikisht. Informacioni i dalë nga një vlerësim i tillë mund të shërbente për përmirësimin në të ardhmen të formulës së unifikuar të pikëzimit me qëllim minimizimin e mëtejshëm të gabimeve në aspektin e përfshirjes dhe përjashtimit të kandidatëve.

Mjaftueshmëria e masës së përfitimit dhe ndikimi në uljen e varfërisë

Rekomandimi nr. 202 i ILO-s për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale përcakton si parime kyçe “mjaftueshmërinë dhe parashikueshmërinë e përfitimeve” dhe vlerësimin e vazhdueshëm të nivelit të garancive bazë të sigurimit shoqëror përmes një procedure sa më transparente. Në këtë aspekt, Rekomandimi nr. 202 i ILO-s parashikon se “niveli minimal i të ardhurave të përcaktuara në nivel kombëtar mund të korrespondojë me vlerën monetare të një sërë mallrash dhe shërbimesh të nevojshme, kufijve kombëtarë të varfërisë, pragjeve të të ardhurave për ndihmën sociale ose pragjeve të tjera të krahasueshme të përcaktuara nga ligji apo praktika.”²

Në Shqipëri vihet re mungesa e përkufizimit zyrtar të të ardhurave minimale të garantuara si dhe mungesa e specifikimit me ligj të nevojave minimale që duhet të plotësohen nëpërmjet programit të Ndhmës Ekonomike. Pavarësisht mungesës së përkufizimit për të ardhurat minimale, sipas disa treguesve të tjerë të mjaftueshmërisë masa e përfitimit nga skema e Ndhmës Ekonomike është dukshëm e ulët. Siç tregohet në Tabelën 2, pagesa e NE-së mbulon vetëm 14.0 përqind të pragjeve të rrezikut të varfërisë për një familje me një person të vetëm dhe 32.8 përqind për një familje me dy të rritur dhe dy fëmijë. Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të masës së pagesës së Ndhmës Ekonomike për familjet me tre ose më shumë fëmijë në vitin 2022, vlera e saj rezulton të jetë më pak se 40 përqind e pagës minimale.

Për më tepër, sipas Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës të zhvilluar nga Instituti i Statistikave në Shqipëri në vitin 2020, pagesa mujore e Ndhmës Ekonomike për frymë ishte 1,262 lekë që përbën 13.5 përqind të të ardhurave totale për frymë të të gjithë popullsisë dhe 29.7 përqind të të ardhurave totale për frymë të decilit me të ardhurat më të ulëta.

Tabela 2. Krahasimi i pagesës së Ndhmës Ekonomike me katër nivelet minimale sociale, 2022

Përbërja e familjes	1 i rritur	1 i rritur dhe 1 fëmijë	2 të rritur	2 të rritur dhe 2 fëmijë	2 të rritur dhe 3 fëmijë
Pagesa e NE-së	2,178 Lek	3,267 Lek	3,703 Lek	10,692 Lek	12,672 Lek
Si % e pragut të rrezikut të rënies në varfëri për përbërjen përkatëse të familjes (vlera e vitit 2020)	14.0	-	-	32.8	-
Si % e pagës minimale	6.4	9.6	10.9	31.4	37.3
Si % e pagesës së papunësisë	12.8	19.2	21.8	62.9	74.5
Si % e pensionit social	25.4	38.0	43.1	123.5	147.6

Burimi: ILO, 2022.

2. Shih nenet 3 dhe 8 të Rekomandimit Nr. 202 të ILO-s.

Shënim: Supozohet se personi kryefamiljar është grua dhe të rriturit janë nën moshën 65 vjeç.

Duke patur parasysh nivelin e ulët të pagesës dhe shpenzimet e ulëta të përgjithshme lidhur me përfitimet nga skema e Ndhmës Ekonomike (nën 0.3 përqind të PBB-së), numri i familjeve përfituese të NE-së që mund t'i shpëtojnë kthetrave të varfërisë është i ulët. Ndërkohë që 61.5 për qind e pagesës së Ndhmës Ekonomike shkonte për familjet e kuintilit më të ulët, ndikimi i programit të NE-së në uljen e rrezikut të varfërisë ishte i kufizuar. Siç tregohet në Figurën 2, përpara ofrimit të çdo transferte sociale, 37.9 përqind e popullsisë rrezikonte të binte në nivelin e varfërisë (nën 60 përqind të të ardhurave mesatare të ekuivalizuara në dispozicion). Sa i takon transfertave sociale, sistemi i pensioneve kontribuoi në uljen e shkallës së rrezikut të rënies në varfëri me 13.1 pikë përqindje, ndërsa transfertat e tjera sociale, duke përfshirë programin e NE-së, e ulën më tej normën e rrezikut të rënies në varfëri me 3.0 pikë përqindjeje. Si rezultat, 21.8 përqind e popullsisë vlerësohej në rrezik varfërie. Nga ana tjetër, numri i vlerësuar i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike përfaqësonte 8.8 përqind të popullsisë.




Figura 2. Ndikimi i transfertave sociale në uljen e rrezikut të varfërisë, 2020

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

Ofrimi i shërbimeve sociale nga pushteti vendor

Shërbimet sociale luajnë rol kyç në punën për adresimin e nevojave specifike të grupeve të ndryshme të cenueshme për të shmangur ose lehtësuar përjashtimin e tyre social. Mbulimi i shërbimeve sociale në Shqipëri është shumë i ulët. Në një vlerësim të kryer nga Shërbimi Social Shtetëror në vitin 2019, vetëm 0.57 për qind e popullsisë ka marrë shërbime sociale, 28 përqind e bashkive nuk kanë ofruar shërbime të kujdesit social, 59 përqind nuk kanë ofruar shërbime të kujdesit social për të moshuarit dhe 57 përqind e tyre nuk ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Të dhënat në lidhje me masën e referimit të përfituesve dhe aplikantëve të Ndhmës Ekonomike tek shërbimet sociale sipas nevojës mungojnë. Ky referim duhet të kryhet nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Megjithatë, bashkitë raportojnë se në 38.4 përqind të njësive administrative nuk janë krijuar njësi të tilla dhe nuk është caktuar stafi i nevojshëm për të kryer funksionet e referimit. Sfidat ekzistojnë edhe në lidhje me kapacitetet profesionale të stafit, mungesën e shërbimeve specifike në dispozicion për menaxhimin e rasteve dhe buxhetin e

pamjaftueshëm të strukturave që merren me shërbimet sociale.

Në vitin 2018, pas transferimit të përgjegjësisë për shërbimet sociale tek pushteti vendor, u krijua Fondi Social si një mekanizëm i përkohshëm për të mbështetur bashkitë për të marrë përsipër këtë rol të ri dhe në veçanti për të ofruar mbështetje financiare për shërbimet sociale. Ofrimi i kësaj mbështetjeje është ende në proces e sipër pas lëshimit të tre thirrjeve për aplikim nga Fondi Social, ku deri më tani janë miratuar për financim 22 nga 67 aplikime nga thirrja e parë dhe e dytë.

Kohëzgjatja e përfitimit dhe përpjekjet për përfshirjen ekonomike

Përveç sigurimit të të ardhurave për familjet e cenueshme, një objektivi tjetër i programit të Ndhmës Ekonomike është edhe lidhja e përfituesve në moshë pune me mundësitë e punësimit. Programi Kombëtar për Daljen nga skema e Ndhmës Ekonomike për përfituesit në moshë pune synon të mbështesë pikërisht këta përfitues përmes programit të punëve publike, subvencioneve të punësimit që u paguhen sipërmarrjeve (paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore) dhe arsimit dhe formimit profesional.

Synimi është që përfituesit në moshë pune të punësohen ose të trajnohen përmes sistemeve përkatëse të referimit për përfshirjen e tyre ekonomike brenda një periudhe pesëvjeçare, që është kohëzgjatja maksimale për përfitimin e pagesës së Ndhmës Ekonomike. Për këtë qëllim, përfituesit në moshë pune janë të detyruar të regjistrohen në zyrat vendore të punësimit si punëkërkues. Megjithatë, në fund të vitit 2021, sipas Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, vetëm 22,167 përfitues të Ndhmës Ekonomike, ose rreth 15 përqind e përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune, janë regjistruar në zyrat e punës. Nga ky grup, 34 përqind ishin në moshën 50 vjeç e lart. Një numër i madh i përfituesve të Ndhmës Ekonomike në zonat rurale nuk janë të regjistruar në zyrën e punësimit për faktin se, me ligj, ata konsiderohen si të vetëpunësuar dhe për rrjedhojë nuk përfitojnë statusin e punëkërkuesit të papunë.

Megjithatë, përpjekja për mbështetjen e aktivizimit të kësaj kategorie përfituesish është ndërprerë për shkak të mungesës së koordinimit efektiv midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në nivel qendror dhe vendor, por edhe për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19. Që nga viti 2022, qeveria ka arritur të rigjallërojë mekanizmin e referimit të anëtarëve të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike, të cilët nuk punojnë. Zyrat e punës po ndjekin situatën e anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike për të adresuar në mënyrë sistematike sfidat me të cilat përballen. Sipas raportimeve, gjatë vitit 2022, më shumë se 3,000 përfitues të Ndhmës Ekonomike janë punësuar ose kanë marrë formim profesional. Pavarësisht tendencave pozitive të vërejtura kohët e fundit, mungesa e mbështetjes efektive për garantimin e punësimit të kësaj kategorie përbën një shqetësim serioz, pasi për një numër të madh të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike viti 2023 është viti i fundit i periudhës pesëvjeçare të parashikuar për përfitimin nga kjo skemë.

Qeverisja e mirë dhe trajtimi i barabartë

Standardet ndërkombëtare bëjnë thirrje për “menaxhim dhe administrim financiar transparent, të përgjegjshëm dhe të shëndoshë” të sistemeve të mbrojtjes sociale.³ Për vënien në jetë të këtyre parimeve, ankorimi i skemave dhe përfitimeve në ligj është një parakusht i rëndësishëm. Kuadri ligjor do t’i jepte mundësinë dhe të drejtën edhe popullatës për t’i kërkuar llogari qeverisë.

3. Shih Paragrafi 3(j) i Rekomandimit Nr. 202 të ILO-s.

Masa dhe kohëzgjatja e përfitimeve nga programi i Ndhmës Ekonomike, popullsia e synuar, mekanizmi i shënjestrimit, mekanizmat e ankimimit dhe mënyra e shpërndarjes, si dhe rolet dhe përgjegjësitë për çdo hap përgjatë procesit të zbatimit janë të parashikuara në Ligjin Nr. 57/2019 dhe në një sërë legjislacionesh të tjera. Një aspekt shqetësues në këtë pikë është mungesa e informacionit për publikun në lidhje me mënyrën e peshimit të treguesve në formulën e unifikuar të pikëzimit. Përkufizimi i kriterëve të kualifikueshmërisë së aplikantëve duhet të jetë i hapur për debat politik dhe kontestim. Deklaratat e rreme duhet të zbulohen dhe sanksionohen nëpërmjet kontrolleve dhe verifikimeve përkatëse dhe jo nëpërmjet mungesës së transparencës në lidhje me kriteret e kualifikueshmërisë.

Sa i takon zbatimin e ligjit, një pengesë kyçe për garantimin e menaxhimit dhe administrimit të shëndoshë të programit të Ndhmës Ekonomike është numri i pamjaftueshëm i personelit me aftësitë e duhura, veçanërisht në nivel vendor. Sipas një ankete të zhvilluar për këtë qëllim, 80 përqind e bashkive janë përgjigjur se numri aktual i personelit është i pamjaftueshëm.⁴ Kjo situatë kombinohet edhe me mungesën e koordinimit ndërinstitucional. Si rezultat, disa nga rregullat nuk zbatohen plotësisht në praktikë. Një mungesë e tillë garancie për trajtimin e barabartë të aplikantëve dhe përfituesve mund të minojë përfundimisht besimin tek programi dhe institucionet publike në përgjithësi.

Një tipar kyç për çdo sistem të mbrojtjes sociale të bazuar tek të drejtat janë mekanizmat e ankimimit dhe apelimit pasi ato kontribuojnë për garantimin e zbatimit të duhur të dispozitave ligjore. Ato shërbejnë edhe si një mekanizëm i dobishëm reagimi për administratorët e skemës dhe bëjnë të mundur zbulimin dhe ndoshta korrigjimin e çdo mosfunksionimi. Prandaj, Rekomandimi nr. 202 i ILO-s u bën thirrje qeverive të ofrojnë “procedura ankimimi dhe apeli të paanshme, transparente, efektive, të thjeshta, të shpejta, të aksesueshme dhe jo të kushtueshme ... pa pagesë”⁵ për të rritur harmonizimin me kuadrin ligjor.

Bazuar në të dhënat e rajoneve pilotuese, numri i ankesave ka qenë i ulët. Shumica e problemeve adresohen dhe zgjidhen drejtpërdrejt në nivel bashkie. Megjithatë, sipas intervistave të zhvilluara me stafin e bashkisë, familjet aplikante shpesh nuk e kanë të lehtë të shprehin shqetësimet e tyre me shkrim, por preferojnë ta diskutojnë rastin e tyre personalisht me administratorin shoqëror. Dorëzimi i një ankese me shkrim mund të jetë me të vërtetë pengesë për disa përfitues të mundshëm që kanë përgjithësisht nivel të ulët arsimor. Edhe platforma *online ku qytetarët mund të shprehin mendimet e tyre në lidhje me administratën publike mund të mos jetë lehtësisht e aksesueshme për të gjithë. Për të përmbushur qëllimin e tyre, është e rëndësishme që mekanizmat e ankesave dhe apeli të jenë të paanshme, transparente, efektive, të thjeshta, të shpejta dhe të aksesueshme.*

4. Përfundim

Ndërsa është e angazhuar për të përmirësuar më tej programin e Ndhmës Ekonomike në përputhje me Udhërrëfyesin e përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shqipëria duhet të garantojë mbulimin e plotë të popullsisë së varfër dhe të cënueshme duke minimizuar gabimet e përjashtimit dhe duke përmirësuar mjaftueshmërinë e masës së përfitimit nga programi i Ndhmës Ekonomike si dhe të rrisë disponueshmërinë dhe aksesin tek shërbimet sociale për të


4. UNICEF. Anketa për kujdesin social në nivel bashkie – mjedisi institucional, kapacitetet, pengesat, 2022, së shpejti.

5. Shih nenin 7 të Rekomandimit nr. 202 të ILO-s.

ofruar mbrojtje me të ardhura dhe shërbime që plotësojnë nevojat e ndryshme të individëve dhe familjeve pa asnjë dallim. Një element vendimtar që do të garantonte menaxhimin e shëndoshë të programit të Ndhmës Ekonomike dhe përmbushjen e aspiratave të tij për përfshirje ekonomike të kandidatëve të saj, është përmirësimi i mëtejshëm i kapacitetit për zbatimin e tij nëpërmjet përdorimit të një mekanizmi sa më efektiv referimi dhe rritjes së numrit dhe aftësive të personelit në nivelin e qeverisjes vendore. ILO, së bashku me organizatat partnere të OKB-së, janë të gatshme të ofrojnë asistencë të mëtejshme teknike për partnerët trepalësh në Shqipëri për të ndërtuar një sistem të përshtatshëm, të barabartë dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen sociale që nuk lë askënd pas.

ilo.org/budapest

International Labour Organization
Central and Eastern Europe
Mozsár utca 14
Budapest H-1066
Hungary

 facebook.com/ilocentraleasterneurope
 @ILO
 ILOTV